



“AlbAudit” SH.P.K.

**OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS
“TRAINKOS” SH.A. – FUSHË KOSOVË**



**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR PËR FUND VITIN
MË 31 DHJETOR 2025**

Fushë Kosovë, Mars 2026



“AlbAudit” SH.P.K.

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

PËR: MENAXHMENTIN E OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A. – FUSHË KOSOVË

Opinion i kualifikuar

Ne i kemi audituar Pasqyrat Financiare përcjellëse të OPERIMI ME TRENA TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A. (më tutje referuar si “TRAINKOS”), më Adresa Rr. “Salih Puqolli” p.n. Rr. “Sheshi i Lirisë” p.n. Fushë Kosovë, Kosovë, që nga Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2025, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar, Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet, si dhe Përmbledhjen e Politikave Kryesore të Kontabilitetit dhe Shënimeve Shpjeguese.

- Për mendimin tonë përveç efekteve të përshkruara në paragrafin e Bazës për Opinion, Pasqyrat Financiare të TRAINKOS, paraqesin gjendjen e drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën financiare dhe rrjedhat e saj të parasë për vitin e përfunduar, në pajtueshmëri me Standardët Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin të Kualifikuar

- Siç është shpalosur në Shënimin 7 – Prona, pajisjet dhe impiantet, me vlerë prej 1,892,514.82 Euro (31 Dhjetor 2024: 2,241,210.18 Euro), TRAINKOS nuk ka kryer rivlerësimin e këtyre asetëve që nga viti 2007. Si rezultat, asetet vazhdojnë të raportohen me kosto historike dukshëm më të ulët, pavarësisht faktit që ato ende gjenerojnë përfitime ekonomike (rrjedhje të parasë). Kjo praktikë bie ndesh me parimin e përputhjes, duke mos reflektuar vlerën reale dhe aktuale të asetëve në pasqyrat financiare.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimit e bërë. Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga Subjekti Politik dhe shoqëria në përputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se



“AlbAudit” SH.P.K.

evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit - Theksim i Çështjes

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Ne terheqim vemendjen lidhur me momentet e mëposhtme:

- *Pasqyra e Rrjedhës së Parasë – Aktiviteti Financues* - Në këtë pasqyrë figuron shuma prej (6,398.04) Euro nën rubrikën “*Dividendat e paguara / korigjim i gabimit*”. Duke përdorur metodën alternative të auditimit, nuk kemi arritur të bindemi për saktësinë e raportimit të saj. Kjo pasaktësi lidhet me mos-harmonizimin e detyrimeve të tjera afatgjata me Pasqyrën e Pozitës Financiare.
- *Shënimi 8 – Detyrimet e tjera afatshkurtra* - Për vitin 2025, janë raportuar në vlerë prej 801,141.05 Euro (2024: 998,040.99 Euro). TRAINKOS rezulton në vonesë në pagesën e Kontributeve Pensionale dhe Tatimit në Pagë, duke mos respektuar afatet e përcaktuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant; për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare; të jenë të lira nga gabimet materiale, nga mashtrimi apo nga gabimi; zgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit; bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.





“AlbAudit” SH.P.K.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim mbi këto Pasqyra Financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe të planifikojmë e zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë Pasqyrat Financiare të liruara nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë zbatimin e procedurave që të arrijmë dëshmi audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të Pasqyrave Financiare, qoftë nga gabimi apo nga mashtrimi. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare të entitetit, në mënyrë që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Gjithashtu, auditimi përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm të Pasqyrave Financiare. Ne besojmë që dëshmitë për auditim që i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura që të ofrojmë bazë për mendimin tonë të auditorit.

“AlbAudit” SH.P.K.



Remzi Jashari, Auditor Ligjor

18 mars 2026



HEKURUDHAT E KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A.

Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2025

Fushë Kosovë, Shkurt 2026

PËRMBAJTJA

I. Deklarata e pajtueshmërisë	3
II. Pasqyra e pozicionit financiar	4
III. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
IV. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
V. Pasqyra e rrjedhës së parasë	8
VI. Shënimet e pasqyrave financiare	10-21

I. Deklaratë e Pajtueshmërisë Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2025

Bazuar në njohurit tona më të mira, deklarojmë që pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2025, paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë pozicionin financiar të kompanisë, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryeshefi Ekzekutiv
Agron Statovci



Zyrtari Kryesor Financiar
Burim Bylygbashi



Fushë Kosovë, Shkurt 2025

II. Pasqyra e pozicionit financiar më 31.12.2025

PASURITË	Shënimi	2025	2024
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	301,552.92	528,003.52
Investimet financiare afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	48,674.84	51,179.71
Stoqet	6	465,025.72	420,534.77
Pasuritë e tjera afatshkurtra	5	19,602.42	12,941.07
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		834,855.90	1,012,659.07
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje			
Investimet në filiale			
Investimet financiare afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	1,795,205.31	2,241,210.18
Prona investuese			
Investimet në vijim	7	97,309.51	-
Pasuritë e paprekshme		-	1,524.07
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		1,892,514.82	2,242,734.25
Gjithsej pasuritë		2,727,370.72	3,255,393.32
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	666,778.27	754,837.32
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	8	364,963.00	364,963.00
Interesi i pagueshëm			
Tatimin në fitim i pagueshëm			
Provizionet afatshkurtra			
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër			
Detyrimet e tjera afatshkurtra	8	801,141.05	998,040.99
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		1,832,882.32	2,117,841.31
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë			
Provizionet afatgjata			
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatgjatë			
Detyrimet e shtyra tatimore			
Detyrimet e tjera afatgjata	9	1,376,335.32	1,554,696.31
Gjithsej detyrimet afatgjata		1,376,335.32	1,554,696.31

Gjithsej detyrimet		3,209,217.64	3,672,537.62
EKUITETI			
Kapitali aksionar	10	25,000.00	25,000.00
Fitimet e mbajtura	10	5,267,941.06	(5,711,180.58)
Rezervat e tjera	10	(5,774,787.98)	5,269,036.28
Gjithsej ekuiteti		(481,846.92)	(417,144.30)
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		2,727,370.72	3,255,393.32

Kryeshefi Ekzekutiv
Agron Statovci



Zyrtari Kryesor Financiar
Burim Bylygbashi



III. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

	Shënimi	2025	2024
Të hyrat	11	1,802,563.84	1,745,130.26
Kostoja e shitjes	12	(500,496.50)	(575,602.67)
Fitimi / (humbja) bruto		1,302,067.34	1,169,527.59
Të ardhurat tjera	11	460,017.26	316,243.04
Shpenzimet e shpërndarjes	12	(1,237,104.11)	(1,387,017.69)
Shpenzimet administrative	12	(75,468.83)	(223,959.63)
Shpenzimet e zhvlerësimit	12	(513,119.05)	(363,423.17)
Provizionimi I Llogarive te arketueshme	12	-	-
Fitimi / (humbja) operativ		(63,607.40)	(488,629.86)
Shpenzimet financiare			
Të ardhurat financiare			
Fitimi / (humbja) para tatimit		(63,607.40)	(488,629.86)
Shpenzimet e tatimit në fitim			
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(63,607.40)	(488,629.86)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore			
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit			
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		(63,607.40)	(488,629.86)

Kryeshefi Ekzekutiv
Agron Statovci




Zyrtari Kryesor Financiar
Burim Bylygbashi



IV. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
Gjendja më 01 Janar 2023	25,000.00	(4,989,673.54)	5,264,481.93	299,808.39
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(272,964.62)	-	(272,964.62)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	40,087.44	(1,843.69)	38,243.75
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	25,000.00	(5,222,550.72)	5,262,638.24	65,087.52
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(488,629.86)	-	(488,629.86)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	6,398.04	6,398.04
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	25,000.00	(5,711,180.58)	5,269,036.28	(417,144.30)
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(63,607.40)	-	(63,607.40)
KjoDiferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	(1,095.22)	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2025	25,000.00	(5,774,787.98)	5,267,941.06	(481,846.92)

Kryeshefi Ekzekutiv
Agron Statovci




Zyrtari Kryesor Financiar
Burim Bylygbashi



V. Pasqyra e rrjedhës së parasë më 31.12.2025

	2025	2024
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	(63,607.40)	(488,629.86)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	513,119.05	363,423.17
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		
Amortizimi i pasurive të paprekshme		
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	-	-
Të ardhurat financiare		
Shpenzimet financiare		
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		
Shpenzimet e tatimit në fitim		
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare tjera	2,504.87	392,358.09
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	(44,490.95)	(7,706.16)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	(6,661.36)	10,033.74
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare tjera	(284,958.99)	156,661.23
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	(178,360.99)	95,273.13
Tatimi në fitim i paguar		
Interesi i paguar		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	(62,455.77)	521,413.34
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(157,596.80)	(518,072.35)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		
Interesi i arkëtuar		
Dividendat e arkëtuara		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(157,596.80)	(518,072.35)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë	-	1,856.36
Dividendat e paguara/korigjim i gabimit	(6,398.04)	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		
Ripagimi i kredive dhe huave		
Pagesat e lizingut financiar		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	(6,398.04)	1,856.36
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	(226,450.61)	5,197.35
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	528,003.53	522,806.17
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	301,552.92	528,003.52

Kryeshefi Ekzekutiv
Agron Statovci




Zyrtari Kryesor Financiar
Burim Bylygbashi



VI. Shënimet për “Pasqyrat Financiare” për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2025

1. Informata të përgjithëshme

Hekurudhat e Kosovës -Trainkos - Sh.A. (“Shoqëria”) është kompani aksionare e inkomporuar më 16 Gusht 2011 në datën e regjistrimit dhe sipas Regjistrimit të Biznesit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përkatësisht Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë më datë 23 Gusht 2011 me numër regjistrimi të biznesit 70773120, kapitali fillestar i regjistruar është në shumën prej 25,000.00 Euro. Ai përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me çmim prej 1 euro për aksion. Adresa e regjistruar dhe vendi kryesor i biznesit, Hekurudhat e Kosovës -Trainkos - Sh.A. është Fushë Kosovë. Pronare e kompanisë është Qeveria e Kosovës.

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 33 paragrafi 1, të Ligjit mbi Hekurudhat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-076, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr.01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26 Shkurt 2010 mori Vendim mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës Sh.A.

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087, për “Kompanitë Publike”; Ligjit Nr.02/L-123, për “Shoqëritë Tregtare” dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr.05/110 të datës 26.02.2010 për ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a. themelon: “Shoqërinë Aksionare “Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës” Sh.A. me numër të biznesit 70773120, e cila është përgjegjëse për pasuritë, detyrimet, që rrjedhin si pasojë e këtij transformimi. Shkurtesa e emërimit është “TRAINKOS” Sh.A.

Selia e kompanisë gjendet në Komunën e Fushë Kosovës “Salih Puqolli” p.n. Kompania mund të zhvillojë aktivitetin e saj në gjithë territorin e Kosovës dhe jashtë saj.

Kompania, sipas Statutit të saj dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës mund të hapë Qendra zyra përfaqësuese, filiale, degë dhe kompani të tjera si në Republikën e Kosovës ashtu edhe jashtë vendit.

Shpërbërja (ndarja) financiare e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. është bërë nga grupi punues i përbërë prej tetë anëtarëve bazuar në vendimin e dates 18.05.2010 Nr.571. në bazë të cilit vendim është bërë ndarja e mjeteve financiare, ndarja e borxheve dhe ndarja e obligimeve financiare në dy kompani të reja (“INFRAKOS” Sh.A. dhe “TRAINKOS” Sh.A.)

1.1.Aktivitetet biznesore të kompanisë

Aktiviteti kryesor i kompanisë është transporti hekurudhor nderurban i pasagjerëve dhe transportit i mallrave dhe shërbimet hekurudhore në baza komerciale. Rrjeti hekurudhor përbëhet prej rreth 333 km pa binar elektrifikues. Linja kryesore shkon Veri -Jug duke lidhur Maqedoninë me kufirin e Serbisë, në veri të Mitrovicës. Një linjë më tej shkon në drejtim të perëndimit nga Prishtina në Pejë dhe në drejtim të Lindjes nga Prishtina në Podujevë (Merdare-kufi me Serbinë).

2. PASQYRA E POLITIKAVE KONTABËL

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi të Kosovës si dhe standardet e kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.

2.2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyra financiare është raport financiar për qëllime të përgjithshme i cili përgatitet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë, me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe në harmoni me kërkesat e Këshillit Kosovar për Raportime Financiar, si dhe për nevoja të Menaxhmentit dhe shfrytëzuesve tjerë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me kostot historike të pasurive dhe detyrimeve për çka ka dëshmi të mjaftueshme.

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, të përfshira edhe numrat pas presjes dhjetore. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe po qëse nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar.

Përgatitja e pasqyrave financiare konform SNRF-ve kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkojnë menaxhmentit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit.

Periodha raportuese e Shoqërisë përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore pra 01 Janar deri më 31 Dhjetor të çdo viti.

2.3. Valuta e këmbimit

Monedha raportuese e Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A. është njësia monetare e Unionit European (Euro) njëherit edhe përdorimi i kësaj valute në vendin tonë, e aprovuar nga Qeveria e Kosovës së bashku me Bankën Qendrore të Kosovës.

Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

2.4. Prona, Impiantet dhe Paisjet

Vlera e pronës, impianteve dhe paisjeve të “Trainkos” më 31 Dhjetor 2025 janë bartur në bazë të parimit të konsistencës, respektivisht vazhdimësisë së vendimit të komisionit për ndarje, sipas kostos minus zhvlerësimi i akumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes.

Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga pasqyra e pozicionit financiar kur shitet ose kur tërhiqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.

Riparimet dhe mirëmbajtja (operative) ngarkohen në pasqyrën operative atëherë kur ndodhin shpenzimet.

Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk është e zhvlerësuar.

Shpenzimet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo janë njohur si asete të ndara, në mënyrën e duhur, vetëm atëherë kur përfitimi ekonomik i mundshëm lidhur me to mund të rrjedhë në kompani dhe vlera e mjetit mund të matet seriozisht.

Shkalla e zhvlerësimit të asetëve llogaritet sipas Sndardadeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit:

Ndëtesat	5%
Makineritë	10%
Automjetet dhe paisjet tjera	20%

2.5. Zhvlerësimet e asetëve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shumica bartëse e një asemi nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një asemi e tejkalo vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihen në pasqyren e të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një asemi është çmimi më i lart shites neto i një asemi dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shumica e arritshme nga shitja e një asemi në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë në të ardhmen e flukseve të parasë që pritet të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një asemi dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojnë të holla.

2.6. Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuter. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asetet janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metoden lineare përderisa kostoja e një asemi të paprekshëm shlyhet përgjat kohëgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

2.7. Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga asemi financiar skadon, ose kur asemi financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar.

Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksioneve, me përjashtim të asetëve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

2.8. Mjetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë asetet financiare të mbajtura për tregti. Asemi financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kryesisht është përvetësuar për qëllim shitje në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori janë klasifikuar si asetet qarkulluese. Kompania nuk ka asetet të klasifikuara në këtë kategori deri në datë të raportimit.

2.9. Kreditë dhe të arkëtueshmet

Huat dhe të arkëtueshmet janë asetet financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Këto janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e pasqyres së pozicionit financiar. Kreditë dhe të arkëtueshmet e kompanisë në datën e pasqyres së pozicionit financiar përbëhen nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

2.10.Stoqet

Stoqet e kompanisë “Trainkos” janë kryesisht materiale dhe pjesët rezervë të cilat janë të lidhura kryesisht me funksionimin e transportit hekurudhor të mallrave dhe shërbimeve. Vlera e stoqeve është vlersuar me koston historike, më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshinë shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre.

2.11.Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë bartur në shumat e faturuara, ndonëse nuk kemi hasur të jenë reduktuar nga provizioni i cili nuk është bërë për dëmin e tyre. Provizioni për borgjet e këqija mund të vendoset me vendime të vlefshme, kur ka evidencë objektive se kompania nuk do të jetë në gjendje ti mbledhë të gjitha shumat e pritura.

2.12.Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në pasqyren e pozicionit financiar sipas koston. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

2.13.Kapitali aksionarë

Kapitali aksionarë përbëhet nga vlera monetare e kontribuar,e regjistruar në librat e kompanisë në shumën prej 25,000.00 € shumë kjo e deponuar në llogari bankare.

2.14.Rezervat

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendjen fillestare të pasqyrës së pozicionit financiar në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionari i kompanisë.

2.15.Përfitimet e punëtorëve

Numri i të punësuarve në “Trainkos” Sh.A. për vitin 2025 ka qenë 148 punonjës. Në rrjedhat normale të biznesit, entiteti bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluara në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrës së të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

2.16.Tatimi

“Trainkos” Sh.a. është kërkuar që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabël të kalkuluar në përputhshmëri me rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar, si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale.

Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit mund të barten për tu vendosur në pesë vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja(nëse ka patur ndërmarrja).

2.17.Njohja e të ardhurave operuese

Të ardhurat janë njohur me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhjes normale të aktivitetit operativ, zvogëluar nga zbritjet, lejimet të ngjashme dhe kthimet e konsumatorëve .Të hyrat njihen kur mallrat janë dorezuar dhe pronësia është bartur.

Të ardhurat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhen e transaksioneve të kompanisë dhe kur shuma e të hyrave mund të matet besueshëm dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kritere të njohjes së aktiviteteve-specifike janë të bazuara në mallrat ose zgjidhjet e siguruar ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë

Të hyrat nga kontratat me çmime fikse për ofrimin e shërbimeve të transportit në përgjithësi njihen në periudhën që shërbimet janë siguruar, duke përdorur metodën drejtë-vizore mbi afatin e kontratës.

2.18.Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

2.19.Grantet qeveritare

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme se grantet do të mirren dhe kompania do ti përmbush kushtet e bashkangjitura.

Grantet qeveritare lidhur me blerjen e paisjeve, pronës dhe impianteve janë të përfshira në detyrimet jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyrë dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në bazë drejtëvizore sipas shkallës së zhvlerësimit për kategorinë e caktuar.

Grantet qeveritare që lidhen me shpenzimet janë të shtyra dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave gjatë periudhës së nevojshme që të përputhen ato me shpenzimet që ato kanë për qëllim për ti kompensuar.

2.20. Provizionet, detyrimet kontigjente dhe asetet kontigjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluar mund të çojë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shuma e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara.

Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë lidhur me detyrimin e tanishëm. Aty ku ka një numër të detyrimeve të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të kërkohet në shlyerje të obligimit përcaktohet duke marrë në konsideratë klasën e detyrimeve si tërësi. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale.

Të gjitha provizionet rishikohen në çdo datë të raportimit dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

2.21.Detyrimet kontigjente

Një detyrim kontigjent nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloet kur një fluks shpenzimesh është i mundshëm.

2.22.Pasuritë kontigjente

Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloet kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.

Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet.

3. Menaxhimi i riskut financiar dhe kapital

Menaxhimi financiar i riskut të kompanisë bartet nga bordi i drejtorëve.

Objektivat e kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që kompania të vazhdoj me punë në të ardhmen.

Kompania duhet të plotësojë nevojat për mjete financiare, për ti mbuluar shpenzimet operative që rrjedhin nga aktiviteti dhe veprimtaria e saj. Ekziston mundësia për rrezik likuditetit pasi që mjetet financiare mund të mos jenë të mjaftueshme për ti paguar detyrimet në kohë e duhur me një kosto të arsyeshme.

3.1.Risku kreditor

Mjetet financiare të cilat e vënë kompaninë në risk kreditor përbëhen prej parasë në dorë dhe parasë në llogaritë bankare.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë të kompanisë përbëhen kryesisht nga salldot bankare.

Shpalosja e zërave në Poziten e Pasyqres Financiare

4. PARATË NË BANKË DHE ARKË

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë që entiteti i mban në arken e vet për qëllime të pageses së shpenzimeve operative dhe për nevoja tjera të pa parashikuara si dhe paratë që entiteti i ka si të depozituara në bankat tjera. Gjendja e parasë siç janë pasqyruar në pasqyren e pozicionit financiar në këtë notë është si vijonë:

Llogarit Bankare dhe paraja e gatshme	2025	2024
<i>Investimet Kapitale</i>	15.58	0.86
<i>Llogaria Kryesore dhe FLEX</i>	301,304.94	527,282.33
<i>Ministria e Infrastruktures</i>	1.62	0.48
<i>Ministria e Ekonomisë</i>	5.20	3.9
<i>Llogaria e Kredisë</i>	27.52	27.52
<i>Llogaria Kryesore</i>	198.06	
<i>Paraja ne arke</i>	-	688.43
Total:	301,552.92	528,003.52

Paraja e gatshme në llogaritë bankare përfshijnë arkëtimin e faturave, paraja për investimet kapitale nga Qeveria, paraja nga subvencionet nga Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës, dhe paraja në arkë.

5. Llogaritë e Arkëtueshme tregtare

Pasuritë e tjera afatshkurtra	2025	2024
<i>Llogaritë e arkëtueshme</i>	216,335.01	218,859.88
<i>Provizionimi I llogarive të arkëtueshme</i>	(167,680.17)	(167,680.17)
Total Llogari të arkëtueshme	48,674.84	51,179.71

5.1. Llogaritë e arkëtueshme

<i>Railtrans L.L.C</i>	55,500.09
<i>Kompania për menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A</i>	771.19
Total	56,271.28

5.2. Pasuritë e tjera afatshkurtra

Pasuritë e tjera afatshkurtra	2025	2024
<i>Llogaritë e arkëtueshme nga punëtorët</i>	4,254.63	3,026.72
<i>Parapagimet</i>	9,743.97	-
<i>Llogaritë tjera të arkëtueshme (Avanset e dhëna)</i>	5,603.82	9,914.35
Total:	19,602.42	12,941.07

6. STOQET

Gjendja e stoqeve me 31 dhjetor 2025 është shpalosur më poshtë sipas depove:

Stoqet (PJESET REZERVË)	2025	2024
<i>Depo e administrates</i>	8,323.33	7,038.98
<i>Depo Naftes</i>	41,943.28	8,070.65
<i>Depo Vajit</i>	17,479.16	13,338.06
<i>Depo pjeseve rezerve</i>	397,279.95	391,297.54
<i>Pjesë të dëmtuara (jasht perdorimit)</i>	-	-
<i>Stoqet e biletave të papërdorura</i>	-	789.54
Total:	465,025.72	420,534.77

7. PRONA, PAISJET DHE IMPIANTET

Përshkrimi	Toka dhe Pasuria e pa zhvlersueshme	Ndërtesat e strukturat ndërtimore	Automjete Inventar, paisje, etj	Totali
<u>Kostoja:</u>				
Me 01 Janar 2024	229,680.00	1,789,540.46	10,996,339.26	13,015,559.72
Shtesë			518,072.35	518,072.35
Nxjerrje jashta përdorimit				
Me 31 Dhjetor 2024	229,680.00	1,789,540.46	11,514,411.61	13,533,632.07
Shtesë	-	-		-
Nxjerrje jashta përdorimit	-	31,951.99	159,276.72	191,228.71
Me 31 Dhjetor 2025	229,680.00	1,821,492.45	11,673,688.33	13,724,860.78
Zhvlersimi i akumuluar:		(840,762.85)	(10,115,040.90)	(10,955,803.75)
Zhvlersimi i viti 2024		(91,120.58)	(272,302.58)	(363,423.16)
Me 31 Dhjetor 2024	-	(931,883.43)	(10,387,343.48)	(11,319,226.91)
Zhvlersimi i vitit 2025		(91,120.75)	(421,998.30)	(513,119.05)
Me 31 Dhjetor 2025		(1,023,004.18)	(10,809,341.78)	(11,832,345.96)
Vlera neto kontabël 31 Dhjetor 2024:	229,680.00	889,609.02	1,127,068.13	2,214,405.16
Vlera neto kontabël 31 Dhjetor 2025:	229,680.00	798,488.27	864,346.55	1,892,514.82

8. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

<i>Detyrimet e tjera afatshkurtra</i>	2025	2024
Llogaritë të pagueshme	666,778.27	754,837.32

8.1. Llogaritë e pagueshme tregtare

<i>Infrastruktura E Hekurudhave Të Kosovës - Infrakos SH.A.</i>	588,043.66
<i>Hib Petrol SH.P.K.</i>	20,895.30
<i>Pe Macedonia Railways infrast</i>	15,278.93
<i>Telekomi I Kosovës Sh.a.-Mobile</i>	12,496.33
<i>Macedonia Railways</i>	11,992.86
<i>Komuna e FushëKosovës</i>	3,103.58
<i>Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.</i>	2,035.11
<i>Kompania Rajonale E Ujësjetllësit Prishtina SH.A.</i>	1,574.07
<i>Planet Accounting L.L.C</i>	900.00
<i>Sabedin R. Berisha B.I. / N.T.SH. Infoprint</i>	724.00
<i>Ricoh I O.P.</i>	696.50
<i>Epoka E Re B.I. / „Epoka e Re</i>	690.00
<i>Hidro Project Sh.p.k</i>	689.40
<i>Profitech Sh.p,k</i>	596.94
<i>Eurogoma Sh.p,k</i>	592.80
<i>Pm Group Sh.p.k</i>	342.32
<i>InfoSoft System Sh.p.k</i>	389.35
<i>Bms Solutions L.L.C</i>	258.80
<i>MediaTech & Print Sh.p.k</i>	194.50
<i>Telekomi I Kosoves Sh.a-Fikse</i>	137.99
<i>Kompania Rajonale E MbeturinaVe Pastrimi SH.A.</i>	124.00
<i>Posta e Kosoves Sh.a</i>	10.30
<i>KRU Hidrodrini SH.A.</i>	-85.35
Totali	666,778.27

8.2. Detyrimet e tjera afatshkurtra

<i>Detyrimet e tjera afatshkurtra</i>	2025	2024
Obligimet ndaj të punësuarëve	479.91	558.44
Obligimet për tatime dhe kontribute	791,074.58	965,577.45
Obligimet e TVSH	9,586.56	31,905.10
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	364,963.00	364,963.00
Total:	1,166,104.05	1,363,003.99

8.3. Obligime për tatime dhe kontribute:

<i>Detyrimet për ndëshkim dhe interes ndaj ATK-së</i>	388,943.10
<i>Tatimi në paga I pagueshem</i>	292,576.19
<i>Tvsh</i>	31,905.10
<i>Kontributet Pensionale të pagueshme</i>	76,376.15
<i>Tatimi mbi qiranë</i>	1,274.04
Totali	791,074.58

9. DETYRIMET TJERA AFATGJATA

Në detyrimet afatgjata përfshihen grantet për investime kapitale të marrura nga Buxheti i Kosovës. Vlera e paraqitur në pasqyren e pozicionit financiar është që prej themelimit të kompanisë, kjo vlerë zvogëlohet me të ardhurat e shtyra, në bazë të shpenzimeve të zhvlerësimit.

Detyrimet e tjera afatgjata	2025	2024
<i>Të hyrat e shtyra në fillim të vitit</i>	1,547,907.01	1,459,423.18
<i>Të hyrat e shtyra (donacion)</i>	-	-
<i>Rregullime për të hyra të shtyra</i>	-	-
<i>Të hyrat e shtyra gjatë vitit</i>	281,856.27	379,652.63
<i>Të hyrat që trajtohen si stok</i>		25,596.80
<i>Shpenzimet zhvlerësimit të granteve</i>	(460,017.26)	(309,976.30)
Të hyrat e shtyra në fund të vitit	1,369,546.02	1,554,696.31

10. EKUTETI AKSIONAR DHE REZERVAT

Ekuteti aksionar dhe rezervat përbëhen nga kapitali themelues, kapitali rezervë, fitimet (humbjet) e bartura dhe fitimi (humbja) e vitit financiar.

Ekuteti Aksionardhe rezervat	2025	2024
<i>Kapitali themelues</i>	25,000.00	25,000.00
<i>Kapitali rezervë</i>	5,267,941.06	5,269,036.28
<i>Fitimet/Humbjet e bartura</i>	(5,711,180.58)	(5,222,550.72)
<i>Fitimi/Humbja e vitit financiar</i>	(63,607.40)	(488,629.86)
Total:	(481,846.92)	(417,144.30)

11. TË HYRAT

Të hyrat e kompanisë si aktivitet kryesor përfshijnë transportin e mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe shërbime që rrjedhin nga këto aktivitete:

Të hyrat	2025	2024
<i>Të hyrat nga transporti i mallrave</i>	1,985.00	10,704.61
<i>Të hyrat nga transporti i udhëtarëve</i>	78,938.78	59,396.71
<i>Shërbimet tjera</i>	4,010.79	6,000.00
<i>Të hyrat nga Ministria e Infrastruktues</i>	1,062,229.75	1,000,787.51
<i>Të hyrat nga Ministria e Ekonomis</i>	610,000.00	610,725.00
<i>Të ardhurat nga shitja e naftes Infrakos</i>	21,096.10	25,214.79
<i>Të ardhurat nga shitja e skrapit</i>	2,109.60	-
<i>Të ardhurat nga dëmtimi i vagonëve dhe të tjera</i>	-	-
<i>Të ardhurat nga zbritjet e marrura</i>	1,503.26	6.99
<i>Të ardhura tjera</i>	20,690.56	32,294.65
Total:	1,802,563.84	1,745,130.26

Gjatë vitit 2025 kompania ka realizuar edhe këto të ardhura tjera:

<i>Të ardhurat tjera</i>	2025	2024
<i>Të ardhurat e shtyra (asetet)</i>	458,206.82	308,165.58
<i>Të ardhurat (Donacioni Zviceran) dhe subvencion</i>	1,810.44	8,077.46
<i>Të ardhura të jashtëzakonshme</i>	-	-
<i>Të ardhurat nga shitja e pasurisë</i>	-	-
Total:	460,017.26	316,243.04

12. SHPENZIMET

Kompania gjatë vitit 2025 ka realizuar këto shpenzime të cilat janë paraqitur në tabelen e mëposhtem:

<i>SHPENZIMET</i>	2025	2024
<i>Kostoja e shërbimeve</i>	500,496.50	575,602.67
<i>Kostoja e punës</i>	1,237,104.11	1,387,017.69
<i>Shpenzimet e administrates</i>	26,046.76	118,815.31
<i>Shpenzimet operative</i>	49,467.45	105,144.32
<i>Shpenzimet e zhvlersimit</i>	513,119.05	363,423.17
<i>Provizionimi i Llogarive të arketueshme</i>	-	-
Total:	2,326,188.50	2,550,003.16

Në koston e shërbimeve bëjnë pjesë derivatet dhe lubrifikantet në vlerë prej 263,704.42€, qasja në binarë në vlerë prej 168,776.92€, pjesë rezerv vlera prej 20,698.42€ dhe të tjera 47,316.74€.

Te shpenzimet operative është përfshirë edhe gjendja e ATK-se regjistrimi i ndeshkimit dhe interesit për mos pagese të obligimeve të kontributve dhe tatimit në pagë, ndëshkimi dhe interesi i përlllogaritur për vitin 2025.

13. DETYRIMET, PASURITË KONTIGJENTE

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme më qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të ndërmarrjes si dhe në asistimin në mbikëqyrjen e hartimit dhe implementimit të Rregulloreve dhe akteve juridike të aplikueshme në Trainkos Sh.A.

Kompania ka vlerësuar se detyrimet kontigjente dhe provizonet nuk i kanë plotësuar kushtet të regjistruhen si provizione në pasqyrat financiare. Kompania ka bërë ndarjen e detyrimeve dhe provizioneve në kategorit që janë:

Lëndë në kontestet kompenzim dëmi janë gjithsej 26 lëndë prej tyre 20 janë në cilësinë e paditur vlera që parashihet është 766.492 €. Ndërsa lëndët në cilësinë e paditëses janë 6 në vlerë prej 39.229 €.

Lëndët në marrëdhëniet e punës janë gjithsej 8 në vlerë prej 84.822 €.

Lëndët për pagim të borxhi janë 4 gjithsej 2 në cilësinë e pales paditur si dhe 2 të pales së paditur vlerë prej 95.372€.

14. NGJARJET PAS PËRFUNDIMT TË PERIUDHËS RAPORTUESE

Nuk ka patur ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese.

15. TRANSKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Nuk ka patur transaksione me palët e lidhura (indirekt e as direkt).

16. PARIMI I VIJIMËSISË

Vijimësia e kësaj Organizate nuk është e rrezikuar për vitin 2026, këtë e mundësojnë kontratat e nënshkruara me klientët, marrëveshjet e nënshkruara me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Ekonomisë.

17. APROVIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga bordi i drejtorëve, 24 Shkurt 2026 dhe janë autorizuar për publikimin e tyre.



”AlbAudit” Sh.P.K.



**OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A. – FUSHË
KOSOVË**

Letër Menaxhmenti

“Auditimit i Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025”



Tel: +383 44 121 655
Tel: +383 49 121 655
albaudit@hotmail.com

„AlbAudit“ Sh.P.K.
Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 2
70000 Ferizaj Kosove

z. Agron Statovci
Kryeshef Ekzekutiv

z. Burim Bylygbashi
Zyrtare Kryesore e Financave dhe Thesarit

z. Fatmir Berisha
Menaxher i Projektit

OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A. – FUSHË KOSOVË, Republika e Kosovës

**Letër menaxhmentit lidhur me “ Auditimin e pasqyrave financiare për vitin që
përfundon më 31 dhjetor 2025”**

Të nderuar,

Në planifikimin dhe kryerjen e angazhimit tonë, Auditimi i Pasqyrat Financiare përcjellëse të **OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A.**, më adresë: Salih Puqolli p.n Fushë Kosovë, Kosovë,, tutje referuar (**TRAINKOS**) që nga Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2025, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar, Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet, si dhe Përmbledhjen e Politikave Kryesore të Kontabilitetit dhe Shënimeve Shpjeguese, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, për të cilat kemi dhënë **“Opinion i kualifikuar“** më datë Mars 2026, ne e kemi konsideruar të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Këto momente nuk do të përfshijnë medoemos të gjitha çështjet e strukturës së kontrollës së brendshme që mund të konsiderohen si mangësi. Mangësi materiale janë kushtet në të cilat dizajni apo operacioni në një apo më shumë komponente të kontrollës së brendshme nuk e zvogëlon rrezikun e gabimeve të ndodhura prej lëshimeve apo mashtrimeve në vlerat e vogla të cilat do të ishin materiale për llogaritë e audituara të cilat mund të ndodhin dhe të mos vërehen në periudhë kohore nga punonjësit në kryerjen e detyrave të angazhuara. Ne nuk vërejtëm çështjet tek kontrolli i brendshëm apo operacionet e Kompanisë lidhur me keto llogari te veçanta të cilat do të konsideroheshin mangësi materiale siç është definuar më lartë.

Sido që të jetë neve kemi vërejtur çështjet tjera lidhur me strukturën e kontrollit të brendshëm dhe disa çështje kontabël dhe operacionale, të cilat janë të prezantuara në raportet e bashkangjitur dhe janë të listuara në tabelën e përmbajtjes.



Tel: +383 44 121 655
Tel: +383 49 121 655
albaudit@hotmail.com

„AlbAudit“ Sh.P.K.
Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 2
70000 Ferizaj Kosove

Ne dëshirojmë ta shfrytëzojmë rastin të shprehim falënderimin tonë për bashkëpunimin dhe mirësjellje të treguar nga menaxhmenti dhe stafi i Kompanisë për bashkëpunim dhe ndihmesën e dhënë gjatë auditimit.

Ky raport është i drejtuar për informatë tek menaxhmenti i kompanisë.

Me respekt,

„AlbAudit“ Sh.P.K.

Ferizaj, Mars 2026

PERGJEGJËSIA E DREJTIMIT LIDHUR ME PASQYRËN FINANCIARE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2025

Përgjegjësia e Menaxhmentit

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant; për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare; të jenë të liruar nga gabimet materiale, nga mashtrimi apo nga gabimi; zgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit; bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

Objektivat

Objektivat e kontrollit të brendshëm janë të sigurojë menaxhim më të arsyeshëm, por jo absolut, sigurimin që pasuritë janë të mbrojtura nga humbjet e përdorimit të paautorizuar ose dëmtimit, dhe se transaksionet ekzekutohen në përputhje me autorizimin e menaxhmentit dhe regjistrohen në mënyre që të lejojnë përgatitjen e pasqyrës në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kontrollat e brendshme që drejtimi i vlerëson të domosdoshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrës pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

Kufizimet

Për shkak të kufizimeve ekzistuese në çdo kontroll të brendshëm, ndonjë deklarami të gabuar, mund të ndodhin e të mos zbulohen gabime ose eventualisht mashtrime. Gjithashtu parashikimet e çdo vlerësimi të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme janë subjekt i rrezikut, për shkak se kontrolli i brendshëm mund të bëhet jo i përshtatshëm për shkak të ndryshimeve në kushtet ose shkallën e pajtueshmërisë me politikat apo procedurat të cilat mund të përkeqësohen.

OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A.

Letër Menaxhmenti lidhur me Auditimi i Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

Mos-Rivlersimi i Pasuris.....	1
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.....	2
Pagesa e Tatimeve dhe Kontributeve.....	3

Baza për Opinionin të Kualifikuar

1. Mos-Rivlersimi i Pasuris

Kriteri:

Standardi Nderkombëtar i Kontabilitetit 16 Aktivitet Afatgjata Materiale, Matja pas njohjes, “Një njësi ekonomike do të zgjedhë ose modelin e kostos ose modelin e rivlerësimit si politikë kontabël të vet dhe do të zbatojë këtë politikë për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale”.

Modeli i rivlerësimit

“Pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese”.

Konstatim:

Siç është raportuar në shënimin 7 - Prona, pajisjet dhe impiantet, në vlerë prej 1,892,514.82 Euro (31 Dhjetor 2024: 2,241,210.18 Euro), TRAINKOS, nuk ka realizuar Rivlersimin e Prona, pajisjet dhe impiantet që nga viti 2007, duke raportuar asetet më kosto historike tejet të ulët, edhe për kundër që keto asete vazhdojnë të sjellin përfitime ekonomike (gjenerim të parasë), në mos harmonizimin e parimit të përputhjes.

Ndikimi- Implikimi

Mos realizimi i procesit të Rivlersimit për Prona, pajisjet dhe impiantet, rrjedhimisht përdorimi i aseteve duke sjellur përfitime ekonomike (gjenerim të parasë), mund të ndikoj në mos respektimin e parimit të përputhjes.

Rekomandim

Rekomandojmë menaxhmentin të zhvilloj politike kontabel në sigurimin e parimit të përputhjes, të realizoj procesin e rivlersimit duke siguruar në raportimin e drejtë dhe të saktë të Prona, pajisjet dhe impiantet, në harmoni më SNK 16.

Komentet e menaxhmentit:

Çështja e rivlerësimit të aseteve është çështje e përsëritur nga auditori vite më radhë. Gjatë vitit 2021, Ndërmarrja ka zhvilluar dy herë radhazi procedurat e prokurimit për angazhim të operatorit ekonomik për rivlerësim të pasurisë, mirëpo nuk ka pasur ofertues të përgjegjshëm.

OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS “TRAINKOS” SH.A.

Letër Menaxhmenti lidhur me Auditimi i Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

Kjo çështje është diskutuar edhe me Aksionarin, nga i cili pritet angazhimi i një operatori (vlerësuesi të licencuar) për rivlerësimin e pasurive të të gjitha NP-ve Ndërmarrjeve Publike, përfshirë edhe Trainkos-in. Në këtë drejtim, ndërmarrja ka paraparë dhe ndarë mjete buxhetore për realizimin e këtij procesi.

Deri në angazhimin e operatorit të jashtëm nga ME-Ministria e Ekonomisë, menaxhmenti do të angazhohet në përmirësimin e evidencave të aseteve me qëllim sigurimin e saktësisë së tyre në PF-Pasqyrave Financiare.

Çështjet Kryesore të Auditimit - Theksim i Çështjes

2. Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

Kriteri:

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 7 Pasqyra e flukseve monetare, “Informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm për të pajisur përdoruesit e pasqyrave financiare me një informacion bazë për të vlerësuar aftësinë e njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare ose ekuivalentë të tyre dhe për të vlerësuar nevojat e njësisë ekonomike për të përdorur këto flukse monetare. Vendimet ekonomike që merren nga përdoruesit kërkojnë një vlerësim të aftësisë së një njësie ekonomike për të prodhuar mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare, si dhe kohën dhe sigurinë e gjenerimit të tyre.”.

Konstatim:

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë – Aktiviteti Financues - Në këtë pasqyrë figuron shuma prej (6,398.04) Euro nën rubrikën “Dividendat e paguara / korigjim i gabimit”. Duke përdorur metodën alternative të auditimit, nuk kemi arritur të bindemi për saktësinë e raportimit të saj. Kjo pasaktësi lidhet me mos-harmonizimin e detyrimeve të tjera afatgjata me Pasqyrën e Pozitës Financiare.

Ndikimi- Implikimi

Mos harmonizimi i vlerës së raportuar, mund të ndikoj në raportimin jo të plotë të pasqyrave financiare.

Rekomandim

Rekomandojmë menaxhmentin të sigurohet në raportimin e drejtë dhe të plotë të zërave të paraqitur në pasqyra financiare.

Komentet e menaxhmentit:

Menaxhmenti do të ndërmarrë masa gjatë vitit 2026 për identifikimin dhe korrigjimin e çështjes së evidentuar, në kuadër të kësaj, do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i të dhënave ndërmjet Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë dhe Pasqyrës së Pozitës Financiare, me qëllim sigurimin e saktësisë dhe plotësisë së raportimit financiar.

Menaxhmenti angazhohet që gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2026, zërat e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë të paraqiten në mënyrë të saktë dhe në përputhje të plotë me SNK-Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

3. Pagesa e Tatimeve dhe Kontributeve

Kriteri:

LIGJI Nr. 05/L -028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE, Mbajtja në burim e tatimit në paga dhe mbajtja në burim e kontributeve, Secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara punëtorëve të tij.

“Secili punëdhënës, apo person që kërkohet të mbajë në burim, dorëzon pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit të mbajtur në burim në llogarinë e caktuar nga ATK-ja në një bankë, apo institucion financiar, i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor të lëshuar nga Ministri”.

Konstatim:

Shënimi 8 – Detyrimet e tjera afatshkurtra - Për vitin 2025, janë raportuar në vlerë prej 801,141.05 Euro (2024: 998,040.99 Euro). TRAINKOS rezulton në vonesë në pagesën e Kontributeve Pensionale dhe Tatimit në Pagë, duke mos respektuar afatet e përcaktuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Ndikimi- Implikimi

Mos realizimi i pagesave më kohe, përkatësisht vonesat në pagesa të tatimit dhe kontributeve pensionale, nga Ndërmarrja, mund të ndokoj në aplikomin e ndëshkimeve tatimore, dhe obligimeve shtesë për organizatën.

Rekomandim

Rekomandojmë menaxhmentin që të sigurohet në menaxhimin e likuiditetit në realizimin e pagesave tatimore dhe kontributeve sipas afatefe ligjore dhe në përputhje më ligjet a aplikuar fiskale.

Komentet e menaxhmentit:

Menaxhmenti e konsideron këtë konstatim si një çështje serioze, e cila kërkon trajtim të kujdesshëm dhe adresim të plotë. Gjendja e krijuar lidhet edhe me veprime të ndërmarra nga menaxhmenti i mëparshëm nëpër vitet gjegjëse, për të cilat ekzistojnë dyshime për keqmenaxhim dhe që kanë ndikuar në krijimin e obligimeve të konsiderueshme, duke vështirësuar operimin normal të ndërmarrjes.

Ndërmarrja vazhdon të përballet me vështirësi financiare, për çka gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e situatës, përfshirë reduktimin e shpenzimeve dhe masa të tjera kursimi. Në vitin 2024 janë bërë edhe përpjekje të kryerjes së obligimeve përmes mjeteve që i marrim nga ME-Ministria e Ekonomisë, por që gjatë paraqitjes së planit të pagesave të njëjtat janë refuzuar nga ministria me arsyetimin se janë paguar një herë nga ministria në vitet 2020-2022 dhe se nuk paguajnë serish këto borgje te vjetra.

Për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe duke marrë parasysh edhe kufizimet operative (përfshirë ndërprerjen e operimit në linjës së 10-të e cila vazhdon te jetë e mbyllur), ndërmarrja ka paraqitur kërkesa zyrtare për mbështetje financiare në formë kredie pranë ME-Ministrisë së Ekonomisë (me datë 04.06.2024 me nr.prot 377 dhe 11.12.2025 me nr.prot 960), me qëllim mbulimin e obligimeve të trashëguara nga vitet paraprake. Deri më tani, nuk është pranuar përgjigje lidhur me këto kërkesa).

Megjithatë, menaxhmenti sipas zotimit të vitit paraprak ka arritur te siguroje fonde dhe të zvogëlojë obligimet ndaj ATK-Administratës Tatimore lidhur me saldo fillestare (tatimi baze për Kontribute te 15 muajve, 1 muaj 2020, 11 muajve 2021 dhe 3 muajve 2022)) në shumën prej 206,343.72 Euro në Dhjetor 2025).

Menaxhmenti vlerëson se sigurimi i financimit përmes kredisë do të mundësonte shlyerjen e borxheve dhe ndëshkimeve, si dhe do të ndalonte rritjen e mëtejshme të interesave dhe penaliteteve. Një plan i strukturuar i kthimit të kredisë do të kontribuonte në përmirësimin e likuiditetit dhe në përmbushjen e obligimeve ligjore në mënyrë të qëndrueshme, në përputhje me rekomandimet e auditorit.